

L I G J

Nr.8455, date 4.2.1999

PER NJE TRAJTIM TE VEÇANTE TE FAMILJEVE TE PILOTEVE QE HUMBASIN JETEN NE PERMBUSHJE TE DETYRES GJATE FLUTURIMIT

Ne mbeshtetje te neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE V E N D O S I:

Neni 1

Pjesetaret e familjes ne ngarkim te pilotit qe per shkak te detyres gjate fluturimit humbasin jeten, perfitojne pension familjar ne masen 100 per qind te pages referuese baze mujore te muajit me te fundit kalendarik te sherbimit, pavaresisht nga periudha e sigurimit te te ndjerit. Page referuese baze mujore te muajit me te fundit kalendarik te sherbimit eshte paga e muajit me te fundit sipas legjislacionit ne fuqi.

Pjesetaret e familjes dhe kushtet ne te cilat ata perfitojne kete pension jane ato te percaktuara ne nenin 40 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e shqiperise".

Pjesetaret e familjes qe gezojne nje pension tjeter kane te drejte te zgjedhin pensionin me te favorshem.

Keshilli i Ministrave rrit pensionet familjare te mesiperme ne nje mase te caktuar, sa here rriten dhe pensionet e tjera

Neni 2

Shpenzimet per pensionet familjare te mesiperme per vitin 1999 perballohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore. Caktimi dhe administrimi, si dhe dhenia e pensioneve behet nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore.

Neni 3

Pjesetareve te familjes, ne ngarkim te pilotit qe per shkak te detyres gjate fluturimit humbet jeten, u jepet nje shperblim i menjehershem ne masen 5(pese) paga baze mujore te muajit te fundit kalendarik qe ka marre i ndjeri. Ky shperblim perballohet dhe jepet nga Ministria e Mbrojtjes.

Neni 4

Femijeve te piloteve qe humbasin jeten gjate fluturimit ne permbushje te detyres, shteti u garanton burse, kur perfitojne te drejten e studimit, sipas kriterëve te percaktuara ne akte ligjore dhe nenligjore.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Punes dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences te nxjerrin aktet e tjera nenligjore ne baze e per zbatimin e ketij ligji.

Neni 6

Efektet financiare, per pension familjar sipas nenit 1 per pilotet e shpallur "Deshmor te Atdheut", fillojne nga dita e shpalljes se tyre.

Neni 7

Per kete kategori ushtarakesh, nenet 16 dhe 17 te ligjit nr.8087, date 13.3.1996 "Per sigurimin shoqeror suplementar te ushtarakeve te Forcave te armatosura te Republikes se Shqiperise" nuk zbatohen.

Neni 8

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2315, date 11.2.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Rexhep Meidani